

DITARI  
MUIOR  
**QERSHOR  
2023**

NIS PUNËN TASK FORCA E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT PËR SIGURINË USHQIMORE



26 - 30  
QERSHOR

**12 QARQE  
238 KONTROLLE  
18 MASA ADMINISTRATIVE  
79 PARALAJMËRIME**

Nis punën Task Forca e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për sigurinë ushqimore në sezonin veror me 100 inspektorë të dedikuar për sezonin, për garantimin e sigurisë ushqimore të konsumatorëve në hotele, restorante, pasticeri apo supermarketet, për të garantuar pushime të qeta për të gjithë.



**+11.3%** më shumë eksportë bujqësore në sasi

**+15.3%** më shumë eksportë bujqësore në vlerë

gjatë Janar - Maj 2023

krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë



FERMERË TË MBËSHTETUR ME NAFTË FALAS

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES 2023

NAFTA PËR PUNIMET E MEKANIZUARA NË BUJQËSI

**30,199**

KARTA TE SHPERNDARA



30,199 fermerë të mbështetur me naftë falas për punimet e mekanizuara në bujqësi, thuajse në të gjitha kulturat bujqësore. Lëvruar e gjithë skema në kohë rekord. Ndërkohë, vijojmë punën me mbështetjen e fermerëve me të gjitha masat e skemës kombëtare deri më 31 dhjetor.

VIZITË ZYRTARE NË KONKURSIN E VERËS "VINI ARBËRESHË", KALABRI, ITALI



Në vizitim të vizitës së kryeministrit në tokat arbëreshe disa javë më parë ku u morën angazhime për më shumë shkëmbim e bashkëpunim mes komuniteteve, Ministria e Bujqësisë u angazhua institucionalisht, për herë të parë, me prodhuesit e verërave dhe Shoqatën e Restoranteve dhe Bujtinave për të prezantuar ekselencat shqiptare në prodhimin e verërave dhe produktet e traditës në konkursin e verës "Verërat Arbëreshe" të organizuar nga prodhuesit e verës arbëresh në Vaccarizzo Albanese.

"E ngrohtë dhe e magjishme lidhja jonë e gjakut, të cilën përmes angazhimit për më shumë shkëmbim e bashkëpunim ekonomik do ta forcojmë më tej me projekte konkrete zhvillimi." - Frida Krifca, Ministër për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural



Miratuan sot Strategjini Kombëtar për sigurinë ushqimore, prioriteti kryesor i punës sonë në mbrojtje të shëndetit të konsumatorit është hapë më i rëndësishëm për t'u përafruar me standartet më të larta të Bashkimit Evropian.

# QERSHOR 2023



Ministria e Bujqësisë organizoi tryezën e përbashkët me përfaqësues të Shoqatës së Miellit si dhe Shoqatës së Bukës, Brumërave dhe Pasticerve për të inkurajuar përpunuesit që në blerjet gjatë fushatës së korreve të këtij sezoni t'i japin prioritet absolut zgjedhjes së prodhimit vendor të grurit të fermerëve shqiptar.



Çelet pika më e re e grumbullimit në Librazhd, një investim i Bashkimit Evropian, i cili u vjen në ndihmë rrëth 360 fermerëve të zonës përritjen e standardeve në grumbullim, magazinim dhe paketim sipas të gjitha kushteve të sigurisë ushqimore, duke rritur cilësinë dhe forcuar zinxhirin e vlerës për prodhimet bujqësore lokale.

## VAZHDON FUSHATA E Matrikulimeve për SHËNDETIN E KAFSHËVE



**MATRIKULLO  
KAFSHËN  
TËNDE!**

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) vijnë me matrikulimin dhe gjurmimin për shëndetin e kafshëve, ku vetëm në vitin 2022 janë kryer mbi 273 mijë vaksinime, +562 mijë matrikullime, rrëth 115 mijë gjurmime për sëmundje të ndryshme. 92% e fermave blegtore u vizituan të paktën një herë nga veterinerët e AKVMB.



## SHQIPËRIA, VENDI I PARË NË MESDHE QË PLOTËSON KUOTËN E PESHKIMIT TË PESHKUT TON PËR VITIN 2023.

E gjithë sasia vjetore prej 264 tonë, kuota maksimale për vendin tonë, është realizuar nga anijet dhe peshkatarët shqiptarë të kompanisë Rozafa. Sektori i peshkimit i është një ndër sektorët shqiptarë më të suksesshëm të dhjetë viteve të fundit. Ministria e Bujqësisë e ka mbështetur këtë industri për rinoimin e flotës, instalimin e pajisjeve frigoriferike, ndryshimin e motorëve, mbështetje me litra naftë e tashmë e kemi përfshirë edhe në skemën kombëtare të trajnimit. Jemi dëshmitarë të një dhjetëfishimi të punësimit dhe të investimeve në peshkim.

## NIS PROGRAMI I RI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM RURAL ME MBËSHTETJE TË QEVERISË GJERMANE DHE QEVERISË ZVICERIANE



Qeveria Gjermane dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Cjerman CIZ, janë partnerë të ngushtë në zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë shqiptare. "Kemi punuar fort, bashkarisht, për ti dhënë jetë një programi të ri mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Rural i cili përqëndrohet mbi prodhimin në serra, frutat dhe arorët, zhvillimin e produkteve të çertifikuara dhe fuqizimin e eksporteve bujqësore, modernizimin e sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike, rritjen e sigurisë ushqimore, promovimin e produkteve tipike dhe të origjinës së dha fuqizimin e agroturizmit." Këtij projekti i bashkohet për herë të parë në këtë program edhe Qeveria Zvicriane me fokus të veçantë në blegtori, kujdesin në ferma blegtorelle përmirësuarin e kafshëve, ruajtjen e qumështit me enë inoksi, paketimi, njehësimin e standardeve, marketimi dhe rritja e aksesit në treg për të forcuar zinxhirët e prodhimit e tregetimit e për të sjellë më shumë të ardhura për blegtoret.

## TREGU I RI NË BELSH ËSHTË GATI PËR FERMERËT



Politikat mbështetëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes krijimit të grupeve të ndërveprimit vendor do i japin një hov zhvillimit të agro-biznesit duke garantuar shitjen e produkteve që ofron zona e Dumresë

## NIS FUSHATA PËR MBROJTJEN E KAFSHËVE NGA MURTAJA AFRIKANE E DERRAVE



Ministria e Bujqësisë nga nisur një fushatë informuese që ka për qëllim informimin dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së derrave, në rrezik nga Murtaja Afrikane e Derrave, e cila është shkatërruese për këtë populatë. Kjo sëmundje përhapet në mënyra të ndryshme dhe me shpejtësi, por ende nuk është shfaqur në Shqipëri dhe nëpërmjet bashkëpunimit me fermerët mund ta frenojmë që kjo sëmundje të prekë dhe vendin tonë.